



22130007



ALBANIAN A: LITERATURE – STANDARD LEVEL – PAPER 1
ALBANAIS A : LITTÉRATURE – NIVEAU MOYEN – ÉPREUVE 1
ALBANÉS A: LITERATURA – NIVEL MEDIO – PRUEBA 1

Wednesday 8 May 2013 (morning)
Mercredi 8 mai 2013 (matin)
Miércoles 8 de mayo de 2013 (mañana)

1 hour 30 minutes / 1 heure 30 minutes / 1 hora 30 minutos

INSTRUCTIONS TO CANDIDATES

- Do not open this examination paper until instructed to do so.
- Write a guided literary analysis on one passage only. In your answer you must address both of the guiding questions provided.
- The maximum mark for this examination paper is *[20 marks]*.

INSTRUCTIONS DESTINÉES AUX CANDIDATS

- N'ouvrez pas cette épreuve avant d'y être autorisé(e).
- Rédigez une analyse littéraire dirigée d'un seul des passages. Les deux questions d'orientation fournies doivent être traitées dans votre réponse.
- Le nombre maximum de points pour cette épreuve d'examen est *[20 points]*.

INSTRUCCIONES PARA LOS ALUMNOS

- No abra esta prueba hasta que se lo autoricen.
- Escriba un análisis literario guiado sobre un solo pasaje. Debe abordar las dos preguntas de orientación en su respuesta.
- La puntuación máxima para esta prueba de examen es *[20 puntos]*.

Shkruaj një analizë të drejtuar letrare duke u bazuar në vetëm një tekst. Në përgjigjen tuaj duhet t'i drejtoheni të dyja pyetjeve udhëzuese.

1.

Në zemër gurë kullash kishte

- Nena ime ishte
Nena kosovare
Linde e rrite e lumja
Nga Nena Dardane
- 5 Gji i dha Teuta
Uje i dha Drini
Nuse shume e bukur
N' shtepine e nje trimi
- 10 Ishte bije e Agrnit
E mese e Skendebeut
Ne sofer i mblidhte
Gjithe burrat e dheut
- 15 Sofren ua shtronte
Me djath e bukevale
Corapa te leshta
U conte ne male
- 20 Ishte ore e malit
Roje e bjeshkeve t' larta
Ishte bareshe e urte
Hidhte fare ne brazda
- Qante bashke me mua
Kur si foshnje qaja une
Ajo kurr nuk lodhej
Kur une e leja pa gjume
- 25 E kur une qeshja
Ajo lahej me gazin tim
Rruget m'ipraronte
Ditet m'i mbushte bekim

30 U lind e u rrit n' kasolle
Jo n' vila n' pallate
Vet lindte e rritte f' mijë
N' djepa maje shpate

Nena ime ishte
Nena kosovare
35 Rënd e rënd tërë ditën
E nuk lodhej fare.

Besar Shkemi, (2003)

- (a) Komento mbi përdorimin e simboleve në këtë poezi.
- (b) Çfarë mund të thuash mbi rëndësinë e marrëdhënieve nënë-bir në këtë poezi.

2.

Dje ishim me mamin, te babi dhe daja. Na lajmëruan që të shtunën. Të dielën unë shkova në Elbasan për të blerë ushqime, u nisa me autobusin e mëngjesit dhe u ktheva me të orës 11.30. Nga daja nuk shkova fare. Pjesën e kohës që më mbeti e lirë e kalova në bibliotekë.

5 Për Burrel u nisëm me gaz, më 6 të mëngjesit. Na shoqëronin dy çuna. Rruga ishte e gjatë dhe e mërzitshme. Ishte zagushi, mamin e zuri makina dhe volli. Kurse unë përpiqesha të kujtoja se ç'gjëra kisha dashur t'u them gjatë gjithë kësaj kohe. Po na lejuan të takohemi vetëm 10 minuta me dajën dhe gjysmë ore me babin. Këtë na e komunikuan në çastin e fundit, ishte diçka e papritur dhe mendimet u shpërndanë fare.

10 Çdo gjë që thoshim me dukej se nuk ishte ajo që duhej. Sikur na e merrnin kohën kot. Minutat iknin shpejt, shumë shpejt dhe në fund pata përshtypjen se nuk kishim folur asgjë, bile as nuk e kishim puthur njëri-tjetrin aq sa duhet. Pastaj më dukej vetja si një fëmijë që i kanë premtuar një lodër dhe e kanë gënjyer.

Prapë rrugë e gjatë dhe e lodhshme. Një interval i shkrutër ndërmjet dy lodhjeve të gjata, të gjata. Ky është babai në jetën time. Babai im i mirë, i fortë.

15 Tani çdo gjë më duket e huaj, pa kuptim, gati qesharake. Njerëz në rrugë, fëmijë që luajnë, autobuzë punëtorësh, djem që pijnë cigare dhe takohen me vajza. Gazeta, fjalë...

Dhe babai im atje. Për 18 vjet rresht. Babai im. Thua do të kalojnë ditë dhe unë do të kthehem prapë në jetën time të zakonshme?

20 Në shqetësimet e mia të vogla, boshe, në vuajtjet e mia qesharake. Ka çaste që më vjen turp nga vetja.

Për 12 vjet nënën e Dritës, Liri Belishovën nuk e lejuan të takonte të shoqin dhe më pas gjatë 15 vjetëve, e çuan 4–5 herë me masa të rrepta sigurimi (me gaz të Ministrisë së Brendshme dhe dy oficerë sigurimi).

Drita Çomo, *Dritë që vjen nga humnera* (2010)

- (a) Diskuto rëndësinë e pjesës mbi marrëdhëniet familjare të përshkruara.
- (b) Komento mbi rëndësinë e teknikës treguese të përdorur.